



**Republika Kosova**  
**Republika e Kosovës**  
**Opština Klokot-Vrbovac/Komuna e Klllokot-Vrbovcë**

Data : 29.06.2018

Në bazë të nenit 12. paragrafi 12.2 ( d ) neni 43. Pika 43.3; neni 45.pika 45.1; neni 46;47.pika: 47.1 ; neni 48.; Ligjit për Qeverisje Lokale nr. 03/L-040 , neni 22. Ligjit për rrugë nr. 3003/11 , si dhe statutit Kuvendit Komunal Klllokot-Vërbovc nga neni 22. Pika 22.1. neni 23. Pika 23.2; ,Kuvendi Komunal merr :

**VENDIM**

**Per formimin e komisionit për vërtetimin e gjendjes në teren lidhur me hapjen e rrugës publike e cila kufizohet me ngastrën 709/4 I 709/3zona katastrale Klllokot**

Neni 1.

**Kuvendi komunal Klllokot –Vërbovc në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit komunal të mbajtur me datë 29.06.2018 në “ Shtëpinë e Kulturës “ në Klllokot merr vendim për formimin e komisionit për vërtetimin e gjendjes në teren lidhur me hapjen e rrugës publike e cila kufizohet me ngastrën nr. 709/4 i 709/3 në zonën katastrale të Klllokotit .**

Neni 2.

Në bazë të kërkesës së qytetarëve me nr. 10646 të datës :20.06.2018 i dorzuar Kuvendit komunal me peticion të qytetarëve në të cilën janë nëshkruar 47 qytetar është shqyrtuar kërkesa nga ana e delegatëve të Kuvendit komunal dhe është marrë vendim si në titullin nga neni 1 .i këtij vendimi. Për tu formuar komisioni nga shtatë antarë , ku 3 antar do të janë nga legjistativi , 2 antarë nga egzekutivi dhe 2 antarë nga ana e qytetarëve , të cilët do të vërtetojnë gjendjen faktike në teren dhe të ndërmarrin masa në pajtim me ligjin në fuqi .

Komisioni përbehet si në vijim :

1. Dejan Vlajković;
2. Naser Shabani;
3. Hidajet Ahmeti;
4. Kelmend Rexhepi;
5. Dorentina Rexhepi;
6. Berat Ahmeti.

Neni 3.

Me votim të publik nga ana e delegatëve të Kuvendit komunal me 11 vota PËR , kundër nuk kishte , ndërsa 3 nuk u deklaruan .Kuvendi komunal merr vendim nga neni 1. Me qëllim sipas nenit 2 . për zbatimin e procedurave ligjore nga Ligji më lart i cekur që ky vendim të zbatohet menjëher nga data e aprovimit për arsye të interesave publike të qytetarëve të komunës tonë . Të mbahet procesverbal në teren dhe të njoftoj kuvendin komunal për të dhënat në teren në afat prej 60 ditësh.

Neni 4.

.Mbas miratimit të këtij vendimi për implementimin e tij do të përkujdeset komisioni i shënuar në vendim , kryetari i komunës dhe drejtorija për Gjeodezi dhe Kataster dhe Urbanizëm .

Neni 5.

Ky vendim nga neni 1 hyn në fuqi menjëher pas nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit komunal Klllokot-Vërbovc dhe vlefshëmërin ligjore nga Ministrija për Qeverisje Lokale , dhe është e vlefshme deri në një ndryshim apo plotësim tjetër nga ana e Kuvendit komunal .

Kopja ti dorzohet :

- MAPL ;
- Kryetarit të komunës ;
- anarëve të komisionit
- drejtoris për Kataster Gjeodezi dhe Urbanizëm
- Kryesuesit K.K .Klllokot –Vërbovc
- Arhivës Komunale

Kryesuesi i Kuvendit Komunal  
Klllokot-Vërbovc

/ Zarko Dejanovic /